



Advocacy Center
for Democratic Culture



UDHËRRËFYES PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT DHE RITJE TË TRANSPARENCËS

OJQ "AKTIV"
korrik 2022



PËRMBAJTJA

Hyrje.....	4
Analizë e gjendjes aktuale të korrupsionit në Kosovë.....	5
Korniza ligjore në Kosovë.....	8
Rekomandime reale dhe praktike për luftimin e korrupsionit dhe rritjen e transparencës në komunë.....	10
Hapat e rekomanduar për hartimin e Planit të veprimit për luftën kundër korrupsionit.....	12
Lista e rekomandimeve me një shpjegim të shkurtër.....	13

HYRJE

Korrupsioni si fenomen shoqërorë është po aq i vjetër sa edhe shoqëria. Historikisht, shoqëria ka reaguar ndaj korrupsionit në mënyra të ndryshme, kryesisht duke u përpjekur që sa më shumë ta parandalojë dhe luftojë por edhe ta përkufizojë si një fenomen krejtësisht negativ. Një përkufizim përgjithësisht i pranuar i korrupsionit do të ishte se ai është shfrytëzimi i paligjshëm i pozitës dhe pushtetit shoqëror dhe shtetëror për përfitime private. Nga ana tjetër, transparencja nënkupton gatishmërinë dhe vullnetin për t'i ofruar publikut të gjerë qasje në informacione të rëndësishme në lidhje me veprimet konkrete sociale, si p.sh. qasshmëria në biznes, duke i lejuar publikut të ketë një pasqyrë mbi operacionet financiare, punësimin e punëtorëve, aktet e biznesit, planet, etj. Pra, korrupsioni dhe transparencja janë dy dukuri sociale të ndërlidhura që zakonisht nuk shkojnë njëra me tjetrën paralelisht. Gjegjësisht, ekzistenca e korrupsionit është më së shumti e lidhur me mungesën e transparencës dhe anasjelltas, transparencja e rritur zvogëlon mundësinë e korrupsionit. Në thelb, transparencja është mjeti më i suksesshëm në luftën kundër çdo forme të keqpërdorimit, e për rrjedhojë edhe korrupsionit. Edhe pse korrupsioni nuk është i përfaqësuar gjithkund në mënyrë të barabartë, nuk do të gabojmë nëse themi se korrupsioni është i pranishëm në shumë aspekte të jetës dhe se asnjë shoqëri nuk është plotësisht immune ndaj kësaj "sëmundjeje", pavarësisht nëse bëhet fjalë për vende të zhvilluara apo më pak të zhvilluara. Praktika, megjithatë, tregon se korrupsioni prek shoqëritë më pak të pazhvilluara në tranzicion, ku nuk ka sundim të plotë të ligjit, ku gjyqësori nuk është i pavarur dhe ku qytetarët nuk kanë një ndërgjegjësim të mjaftueshëm për të gjitha pasojat që sjell korrupsioni.

Korrupsioni si një fenomen shoqëror global ka një efekt shumë negativ në zhvillimin dhe progresin e përgjithshëm shoqëror, demokracinë, rritjen ekonomike, stabilitetin e administratës shtetërore etj. Ai zvogëlon besimin e qytetarëve në institucionet publike dhe cenon ndjeshëm legjitimitetin e tyre. Për shkak të korrupsionit, qytetarët nuk mund të gëzojnë në kapacitetin e tyre të plotë të drejtat sociale, ekonomike dhe politike të garantuara me ligj. Korrupsioni çon në një ndjenjë të përgjithshme pafuqie dhe padrejtësie që mund të përshkallëzohet në një konflikt të plotë dhe/ose kolaps në shoqëri, sepse hap një hapësirë të madhe për kriminelët, madje edhe terroristët për forma të ndryshme të aktiviteteve kriminale që janë të ndaluara me ligj. Sipas disa rregullave të pashkruara, korrupsioni godet më së shumti kategoritë e varfra dhe cenuara të popullsisë, sepse nuk mund të përballojnë "luksin" e dhënies së rryshfetit për të marrë shërbime publike të cilat ligjërisht u takojnë. Prandaj lufta kundër korrupsionit është parim bazë dhe parakusht i menaxhimit të mirë, demokratik dhe të suksesshëm në interes të qytetarëve. Kështu, shoqëritë demokratike dhe të hapura e vendosin luftën kundër korrupsionit si një synim strategjik dhe prioritet të sigurisë kombëtare. Karakteristikat e korrupsionit janë një kategori e ndryshueshme. Ashtu sikurse që korrupsioni merr forma dhe trajta të reja çdo ditë, edhe lufta kundër korrupsionit duhet të përfshijë zgjidhje sistematike dhe mekanizma hetues, ndjekje penale dhe masa parandaluese që janë në hap me kohën dhe tendencat ekzistuese. Mbrojtja parandaluese kundër korrupsionit, si dhe ndryshimi gradual i ndërgjegjësimit të qytetarëve për korrupsionin, po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për një luftë të suksesshme kundër korrupsionit, ngase zbatimi dhe fokusimi ekskluzivisht në mjetet e detyrimit shtetëror ka rezultuar të jetë i pamjaftueshëm. Prandaj është e rëndësishme të promovohet llogaridhënia dhe transparencja, dhe është veçanërisht e rëndësishme të ndërgjegjësohen qytetarët se korrupsioni nuk është vetëm një problem juridiko penal, por edhe një problem moral apo etik. Vetëm kështu mund të parandalohej dhe luftohej korrupsioni në atë masë që mundëson zbatimin e parimit universal të barazisë ndaj çdo qytetari, pavarësisht nga statusi i tij social, ekonomik, kombëtar apo ndonjë tjetër.

ANALIZË E GJENDJES AKTUALE TË KORRUPSIONIT NË KOSOVË

Legjislacioni në fuqi në Kosovë ka paraparë mekanizma të mirë në fushën e parandalimit, luftimit dhe hetimit të korrupsionit. Në bazë të legjislacionit ekzistues, janë themeluar dhe financuar nga buxheti i Kosovës institucionet përkatëse, të cilat kanë mandat për kryerjen e hetimeve paraprake për korrupsion, të mbrojnë sinjalizuesit, të analizojnë dhe eliminojnë shkaqet e korrupsionit, të evidentojnë pronën në pronësi të zyrtarëve publikë dhe të afërmve të tyre të afërt etj. Megjithatë, sipas disa hulumtimeve ndërkombëtare dhe vendore rreth korrupsionit, në Kosovë janë bërë përparime të vogla dhe simbolike në kuptim të luftës sistematike kundër korrupsionit.

Sipas një studimi të UNDP-së "Pulsi publik rreth korrupsionit" të viti 2019, si dhe anketimit të realizuar me qytetarët e Kosovës në maj të vitit 2018, të anketuarit konsiderojnë papunësinë (29.4 %), korrupsionin (13.4 %) dhe varfërinë (8.6 %) si tri probleme më të mëdha me të cilat ballafaqohet Kosova. Mesatarisht, një e katërta e të anketuarve, d.m.th. 25% kanë deklaruar se mendojnë se korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë. Shumica e banorëve të Kosovës (68.8%) besojnë se faktorët më të rëndësishëm për punësim në sektorin publik janë faktorët e pamerituar, si lidhjet familjare, ryshfeti, përkatësia partiake, miqtë dhe në një masë më të vogël pamja dhe gjinia.

Në nëntor 2020, Agjencia kundër Korrupsionit në Kosovë miratoi Strategjinë kundër korrupsionit 2021-2023. në të cilën theksohen disa arsye të mundshme për praninë e korrupsionit në Kosovë, përkatësisht:

- MUNGESA E MEKANIZMAVE EFEKTIV TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË FUSHËN E KUNDËR KORRUPSIONIT
- MUNGESA E AUDITIMIT TË FINANCEVE TË PARTIVE POLITIKE
- MUNGESA E LEGJISLACIONIT TË DUHUR PËR FINANCIIMIN E PARTIVE POLITIKE, PËR MONITORIMIN DHE AUDITIMIN E FINANCEVE TË TYRE
- MUNGESA E NJËSISË PËRGJEGJËSE PËR ANALIZA SEKTORIALE TË RREZIKUT NË LIDHJE ME RREZIQTET NGA KORRUPSIONIT
- MUNGESA E GJOBAVE EFEKTIVE (ADMINISTRATIVE) DHE MOS FORCIMI I MEKANIZMAVE PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT
- MUNGESA E PLANEVE TË INTEGRITETIT NË TË GJITHA INSTITUCIONET PUBLIKE DHE MUNGESA E INSTITUCIONIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E TIJ
- MUNGESA E KONTROLLIT TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE
- QASIA JO E MJAFTUESHME DHE JO E PLOTË NË DOKUMENTET PUBLIKE
- PROBLEMI I NEPOTIZMIT, KONFLIKTIT TË INTERESIT, POLITIZIMIT NË PUNËSIMIN NË ADMINISTRATËN PUBLIKE
- MOS FINALIZIMI I KATEGORIZIMIT/KLASIFIKIMIT TË VENDEVE TË PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL
- MUNGESA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM DHE MENAXHIMI JO I DUHUR I SHPENZIMEVE TË TË HYRAVE VETANAKE TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE
- MOS KONTROLLIMI I NDËRMARRJEVE PUBLIKE KOMUNALE DHE MOS VLERËSIMI I AKTEVE JURIDIKE NË NIVEL KOMUNAL
- MOS KOORDINIMI I DUHUR I INSTITUCIONEVE TË ZBATIMIT TË LIGJIT
- MOS PROFILIZIMI NË INSTITUCIONET E ZBATIMIT TË LIGJIT PËR RASTET E KORRUPSIONIT
- MUNGESA E MEKANIZMIT TË RISHIKIMIT NË INSTITUCIONET E ZBATIMIT TË LIGJIT


¹ Dokumenti është në dispozicion në gjuhët zyrtare në Kosovë në ueb faqen e Kryeministrit të Kosovës:

<https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/12/SRB-Strategjia-kunder-Korrupsionit-2021-2023.pdf>

<https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/12/Strategjia-Kunder-Korrupsionit-2021-2023.pdf>

Është e qartë se karakteristikat e korrupsionit sot ndryshojnë me shpejtësi. Korrupsioni merr manifestime krejtësisht të reja që deri në atë moment nuk ishin të njohura as në teori, as në praktikë. Nga format më të zakonshme të korrupsionit të imët dhe korrupsionit në shkallë të gjerë në kuadër të një shteti, dhe si rregull në sektorin publik, korrupsioni ka filluar të përhapet në sektorin privat dhe të shfaqet në procese të panjohura më parë si p.sh. privatizimi, shpronësimi, prokurimi publik, ndërtimi i infrastrukturës rrugore, ndërtimi i hidrocentraleve të vogla, zhvillimi i qendrave turistike dhe dhënia e lejeve të ndërtimit etj. Në bazë të rezultateve të ekzaminimit të indeksit të korrupsionit në Kosovë nga organizata globale "Transparency International", Kosova vitin e kaluar, pra në vitin 2021 ka zënë vendin 87 nga 180 vendet e mundshme, që paraqet një përmirësim të caktuar në krahasim me vitet e kaluara.

PASQYRA E INDEKSIT TË KORRUPSIONIT NGA VITI 2012 DERI NË VITIN 2021 NË KOSOVË SIPAS HULUMTIMIT TË "TRANSPARENCY INTERNATIONAL"



Përveç në kuadër të një shteti, korrupsioni bëhet i dukshëm edhe në nivel ndërkombëtar në organizatat ndërkombëtare si gjykatat ndërkombëtare, agjencitë ndërkombëtare etj. Prandaj, korrupsioni ndjek me mjaft sukses zhvillimin e shoqërisë, dukurive dhe proceseve shoqërore, duke përfshirë edhe vetë procesin e globalizimit.

Shoqëria në Kosovë gjithashtu nuk ka mbetur immune ndaj korrupsionit. Në këtë pikë është e përshtatshme të përmendet projekti me interes strategjik për ndërtimin e autostradës "Arbën Xhaferi" për në Maqedoninë e Veriut, i cili i kushtoi qytetarëve të Kosovës 53 milionë euro dëmshpërblim si rezultat i një kontrate të hartuar jo mirë dhe neglizhencës së tri qeverive të Kosovës sa i përket obligimeve të tyre sipas kontratës së nënshkruar. Publiku ishte kundër nënshkrimit të kontratave nga qeveritë në largim për mungesë transparence dhe dyshime për korrupsion. Analiza e organizatës së shoqërisë civile Demokracia për Zhvillim (D4D) nga Prishtina madje ka dalë publike me informacionin se ky kompensim i ka kushtuar Kosovës afërsisht 4000 vende të reja pune. Ngjashëm, dyshimi për korrupsion ka ekzistuar edhe kur bëhet fjalë për shpronësimin e tokës për qëllim të ndërtimit të autostradës. Gjegjësisht, zyrtarë të lartë shqiptarë nga Kosova, sipas mediave, me çmime jashtëzakonisht të ulëta kanë blerë tokë në lokacionet ku më vonë është ndërtuar autostrada, që në procesin e shpronësimit nga Qeveria e Kosovës si pronarë të rinj të parcelave të kompensoheshin mijëra herë më shumë. Fatkeqësisht, deri më sot listat e përfituesve të dëmshpërblimit kanë mbetur të pa qasshme për publikun, përkundër faktit se legjislacioni aktual në Kosovë i obligon institucionet kosovare që të ofrojnë qasje në informatat me rëndësi publike sepse bëhet fjalë për shpenzime publike të paguara nga tatimpaguesit.

Në gjysmën e dytë të vitit 2021, organizatat joqeveritare Aktiv dhe ACDC realizuan një hulumtim për nivelin e transparencës dhe korrupsionit në gjashtë komuna me shumicë serbe. Hulumtimi është kryer në komunat: Mitrovica e Veriut, Zubin

Potok, Leposaviq, Zveçan, Graçanicë dhe Shtërpçë. Qëllimi i hulumtimit ishte të shqyrtojë qëndrimet e qytetarëve në lidhje me korrupsionin dhe ndikimin e tij në komunitetet e tyre dhe punën e autoriteteve lokale në komunat: Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq, Zveçan, Graçanicë dhe Shtërpçë. Rezultatet e hulumtimit treguan se tek qytetarët e këtyre gjashtë komunave ka pakënaqësi sa i përket transparencës dhe korrupsionit.

Përkatesisht, sa i përket transparencës, 68% e të anketuarve kanë deklaruar se pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje mund të përmirësohet, ndërsa 63% besojnë se komuna e tyre është transparente në masë të kufizuar ose shumë të kufizuar. Kur bëhet fjalë për përgatitjen e buxhetit komunal, vetëm 29% e të anketuarve kanë deklaruar se ky proces është transparent. Sa i përket korrupsionit, qytetarët e gjashtë komunave në fjalë në Kosovë ishin edhe më kritikë. Gjegjësisht, 68% e të anketuarve kanë deklaruar se besojnë se korrupsioni është i pranishëm në komunitetin e tyre, dhe vetëm 2.3% e të anketuarve kanë deklaruar se korrupsioni nuk është i pranishëm në komunitetin e tyre. Rreth 71% e të anketuarve deklaruan se korrupsioni në pushtetin lokal ka një ndikim të rëndësishëm ose shumë domethënës në jetën e gjithë komunitetit. Rezultatet e hulumtimit treguan se të anketuarit besojnë se në 70% të rasteve korrupsioni manifestohet përmes kërkimit dhe/ose dhënies së ryshfetit. Për më tepër, 45.3% e të anketuarve kanë deklaruar se korrupsioni është i pranishëm gjatë punësimit në sektorin publik, dhe 24% e të anketuarve konsiderojnë se korrupsioni është i pranishëm gjatë prokurimit publik. Është e rëndësishme të theksohet se të anketuarit nga komuna e Mitrovicës së Veriut, Zubin Potokut, Leposaviqit, Zveçanit, Graçanicës dhe Shtërpçës ishin pajtuar me pikëpamjet se autoritetet qendrore janë më të korruptuara.

KORNIZA LIGJORE NË KOSOVË



Në Kosovë, lufta kundër korrupsionit është e rregulluar me këto ligje:

1. Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit²

Ky ligj përcakton statusin dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit, veçanërisht në fushën e raportimit, zbulimit dhe hetimit të korrupsionit, zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit.

2. Ligji nr. 04/L-050 për Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Pronës së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë dhe Ligjin nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050³

Ky ligj përcakton detyrimet e zyrtarëve të lartë publikë për të deklaruar pronën, të ardhurat dhe origjinën e tyre, detyrën e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit për të kontrolluar deklarin dhe kontrollin e pasurisë, si dhe detyrimet e të gjithë personave zyrtarë për të deklaruar dhuratat dhe origjinën e tyre.

3. Ligji nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik⁴

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi i konfliktit të interesit në interesin publik dhe privat të zyrtarëve të lartë në ushtrimin e funksioneve publike.

4. Ligji nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve⁵

Qëllimi i këtij ligji është mundësimi i sinjalizimit të shkeljeve në sektorin publik dhe privat dhe mbrojtja e sinjalizuesve.

Sa i përket transparencës, kjo çështje në nivelin e administratës së pushtetit lokal rregullohet me akte të shumta ligjore dhe nënligjore që janë në fuqi në Kosovë. Është e pamundur të numërohen këtu të gjitha ligjet që trajtojnë këtë çështje dhe nuk është ky qëllimi i këtij dokumenti, duke qenë se transparenca është një nga mjetet më efektive në luftën kundër korrupsionit. Prandaj, në këtë pikë do të përmendim vetëm disa ligje dhe akte nënligjore të rëndësishme që rregullojnë çështjen e transparencës:

1. Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike⁶
2. Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale⁷
3. Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
4. Ligji nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve

² Ligji është në dispozicion në gjuhën serbe dhe shqipe në ueb faqen e Gazetës Zyrtare të Kosovës
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2662#>

³ Ibid:
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2767>

⁴ Ibid:
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16314>

⁵ Ibid:
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18303#>

⁶ Ibid:
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20505#>

⁷ Ibid:
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

Transparenca në nivel lokal rregullohet edhe me akte të shumta nënligjore dhe këtu do të përmendim vetëm disa prej tyre, si p.sh.

1. Udhëzim Administrativ Nr. 03/2020 për transparencë në Komunaa,⁸
2. Rregullore nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës,⁹
3. Udhëzim administrativ Nr. 01/2021 për funksionimin e qendrave të shërbimeve të qytetarëve në komunë,¹⁰
4. Udhëzim Administrativ Nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna,¹¹
5. Rregullore (MAPL) nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës¹²
6. Udhëzim Administrativ Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike
7. Udhëzim Administrativ Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës¹³
8. Vendimi i Qeverisë 07/87 për miratimin e Kartës për hapjen e të dhënave
9. Rregullore nr. 04/2015 për Kodin e mirësjelljes në shërbimin civil të Republikës së Kosovës

⁸ Ibid:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=31852>

⁹ Ibid:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=51194>

¹⁰ Ibid:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=50768>

¹¹ Ibid: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18425>

¹² Ibid: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=51194>

¹³ Ibid: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11404>

REKOMANDIME REALE DHE PRAKTIKE PËR LUFTIMIN E KORRUPSIONIT DHE RITJEN E TRANSPARENCËS NË KOMUNË

E gjithë jeta e qytetarëve zhvillohet në komuna. Komunat, si njësi të vetëqeverisjes lokale në Kosovë, bazuar në Kushtetutën dhe ligjet në fuqi i ushtrojnë kompetencat e tyre (burimore, të besuara dhe të zgjeruara), duke u ofruar qytetarëve shërbime që duhet t'ua lehtësojnë jetën në territorin ku jetojnë dhe punojnë. Prandaj është e nevojshme që në atë nivel, pra në nivelin lokal të administratës, të ketë një plan të qartë, të saktë dhe real që do të mundësonte luftën kundër çdo forme korrupsioni. Prandaj, lufta kundër korrupsionit fillon në momentin kur përfaqësuesit e qeverisë tregojnë një vullnet të qartë dhe dëshirë të singertë për të luftuar kundër këtij shqetësimi social duke miratuar një plan për luftën kundër korrupsionit, të cilin edhe më tej e zbatojnë në praktikë.

Pjesëmarrja e qytetarëve në atë proces është e pashmangshme. Hartimi i një plani për luftë kundër korrupsionit është parakusht për luftimin e korrupsionit, dhe rrjedhimisht rritjen e transparencës në komunë. Përmes një hulumtimi, kërkimi dhe kontrolli të shpejtë të ueb faqeve të komunave dhe institucioneve qendrore të Kosovës, u konstatua se vetëm Qyteti i Prishtinës gjashtë vjet më parë ka miratuar Planin afatshkurtër të integritetit 2014-2016. Në nivel qendror, Agjencia kundër Korrupsionit ka miratuar Strategjinë kundër korrupsionit 2021-2023, e cila flet për korrupsionin në mënyrë të përgjithshme, mirëpo nuk përmban udhëzime specifike për komunat rreth kësaj çështjeje. Megjithatë, vetëm lufta efektive kundër korrupsionit në nivel komunal është garantuesi i çrrënjësjes së korrupsionit. Prandaj hapi i parë dhe themelor në luftën kundër korrupsionit duhet të jetë miratimi i Planit komunal të veprimit në luftën kundër korrupsionit. Një plan i tillë duhet të përmbajë një analizë të qartë të kontekstit lokal (komunal) dhe mekanizmat parandalues kundër korrupsionit në nivel të administratës komunale, në kuadër të cilit plan janë identifikuar kompetencat, fushat, proceset dhe procedurat, rreziqet për shfaqjen e formave të ndryshme të korrupsionit, treguesit (indiktorët) mbi bazën e të cilëve matet, si dhe mënyrat e menaxhimit të rreziqeve, pra mënyrat e eliminimit të tyre. Në këtë dokument përdorim konceptin Planit veprimi për luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës së komunës (specifike). Megjithatë, rritja e transparencës mund të veçohet dhe të përfaqësojë një plan të veçantë të komunës. Në çdo rast, me zbatimin e planeve të veprimit dhe vendosjen e mekanizmave adekuat për monitorimin e zbatimit të tyre, komunat forcojnë rezistencën e tyre ndaj korrupsionit, parregullsisive dhe keqpërdorimit të burimeve publike, përkatësisht fuqizojnë kapacitetet e tyre për mbrojtjen, përfaqësimin dhe realizimin e interesit publik të komunitetit lokal.

Në atë proces, është e nevojshme të merren parasysh të gjitha rregulloret ligjore pozitive (dispozitat ligjore dhe nënligjore të përmendura në kapitullin paraprak) që rregullojnë çështjen e korrupsionit dhe transparencës në Kosovë, Strategjia kundër korrupsionit e përgatitur nga Agjencia kundër Korrupsionit e Qeverisë së Kosovës, si dhe standardet dhe praktiket e mira ndërkombëtare. Megjithatë, në diskutimet me përfaqësuesit e komunave partnere, u arrit në një përfundim të qartë se në nivel të komunave partnere ka nevojë të madhe jo vetëm për këtë udhërrëfyes, por edhe për një dokument akoma më specifik që mund të quhet Modeli i planit komunal të veprimit për luftën kundër korrupsionit, të cilin të gjitha komunat në Kosovë mund dhe duhet ta përdorin në procesin e zhvillimit të planit të tyre në luftën kundër korrupsionit. Gjatë hartimit të këtij udhërrëfyesi, u konstatua se Agjencia Kosovare kundër Korrupsionit apo ndonjë institucion tjetër publik, në përputhje me mandatin e saj, nuk u ka ofruar komunave në Kosovë mundësinë e hartimit të planit të tyre bazuar në një model të paracaktuar me përmbajtje konkrete. Duket se ka shumë nevojë për këtë prandaj dhe ky rekomandim praktik është përfshirë në këtë dokument.

Komunat, në procesin e krijimit të një Planit të veprimit për rritjen e transparencës dhe luftimin e korrupsionit, mund të përdorin hapat e paraqitur në diagramin në vijim:

HAPAT E REKOMANDUAR PËR HARTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR



01 —



DEKLARATË PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

02 —



THIRRJE PUBLIKE PËR ANËTARËT E GRUPIT PUNUES
PËR HARTIM TË PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR
LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

03 —



THEMELIMI I GRUPIT PUNËS PËR HARTIMIN E PLANIT
KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR
KORRUPSIONIT

04 —



DËGJIM PUBLIK PËR DRAFT PLANIN KOMUNAL TË
VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

05 —



THEMELIMI I NJË ORGANI PËR MONITORIMIN E
ZBATIMIT TË MASAVE NGA PLANI I VEPRIMIT PËR
LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

06 —



MIRATIMI I PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR LUFTËN
KUNDËR KORRUPSIONIT

07 —



RAPORT PËR HARTIMIN E PLANIT KOMUNAL TË
VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT,
MËSIMET E FITUARA NGA PROCESI DHE REKOMANDIME

Halat e lartcekur duhet të ndërmerren nga komunat gjatë hartimit të Planit të veprimit për luftën kundër korrupsionit. Gjithashtu, në vazhdim të këtij dokumenti janë propozuar rekomandime të ndryshme praktike për luftë efektive kundër korrupsionit dhe rritje të transparencës (pa ndonjë renditje specifike). Këto rekomandime praktike mund dhe duhet të përfshihen në ndonjë plan të ardhshëm komunal për luftën kundër korrupsionit. Disa rekomandime dhe masa praktike shpjegohen më në detaje për t'u kuptuar më lehtë, ndërsa disa jo sepse vetë titulli i të nënkuptohet se çfarë duhet të bëjnë komunat partnere dhe çfarë duhet të përmbajë Plani i tyre i veprimit për luftën kundër korrupsionit. Rekomandimet praktike nuk janë listuar me ndonjë renditje fikse.

LISTA E REKOMANDIMEVE ME NJË SHPJEGIM TË SHKURTËR



DEKLARATË PËR RRITJEN E TRANSPARENCËS DHE LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

01

Kryetari dhe kryesuesi i kuvendit komunal duhet të deklarojnë publikisht se janë plotësisht të përkushtuar në luftën kundër korrupsionit dhe se në këtë drejtim ndërmarrin masa konkrete për çrënjosjen e çdo forme të korrupsionit në nivel komunal. Deklarata përmes mediave lokale, faqes zyrtare të komunës, rrjeteve sociale duhet t'i prezantohet publikut në formën e një deklarate me shkrim. Në të njëjtën kohë, Kryetari i Komunës, përmes publikimit të Deklaratës, duhet të njoftojë publikun dhe institucionet lokale rreth hartimit të një Plani të veprimit për luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës. Deklarata mund të përmbajë deklarata për angazhimin e administratës lokale në krye me kryetarin e komunës në luftën kundër korrupsionit nëpërmjet nismave të reja që do të synojnë të përcaktojnë rreziqet normative, institucionale, organizative dhe praktike për shfaqjen e korrupsionit, por edhe prezantimin konkret të masave për eliminimin e tyre, përkatësisht eliminimin e shkaqeve të shfaqjes së korrupsionit, keqpërdorimeve dhe parregullsive si dhe eliminimin e keq menaxhimit në kuptimin më të gjerë të fjalës.

THIRRJE PUBLIKE PËR ANËTARËSIM NË GRUPIN PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

02

Ligjet në fuqi parashikojnë procedura të qarta për zhvillimin e strategjive komunale që parashikojnë një qasje pjesëmarrëse. Megjithatë, një hap i rëndësishëm në këtë proces do të ishte sigurisht nëse pushteti lokal në krye me kryetarin e komunës do të shpallte një ftesë publike për individët e interesuar, publikun profesional dhe institucionet vendore për të marrë pjesë në procesin e hartimit të Planit të veprimit për luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës. Thirrja publike duhet të përmbajë kushtet bazë rreth integritetit personal, të cilat kushte anëtarët e grupit punës duhet t'i plotësojnë për të marrë pjesë në hartimin e Planit të veprimit për rritjen e transparencës dhe luftën kundër korrupsionit. Po ashtu, në ftesë duhet theksuar se plani në fjalë vlen ekskluzivisht për banorët e komunës dhe se prioritet do të kenë të gjithë ata që merren me këtë tematikë apo kanë ndonjë rezultat në luftën kundër korrupsionit në komunë. Komuna në ftesë duhet të theksojë afatet kohore dhe e-mail adresën në të cilën anëtarët e mundshëm të grupit të punës mund të dërgojnë CV dhe/ose të shprehin interesin për të marrë pjesë në këtë proces.

THEMELIMI I GRUPIT PUNËS PËR HARTIMIN E PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

03

Grupi punues duhet të formohet me vendim të kryetarit të komunës dhe të konfirmohet në Kuvendin e Komunës. Në përbërjen e tij grupi punues mund të ketë përfaqësues:

- të administratës lokale dhe drejtorive specifike të komunës,
- të qytetarëve (nuk është e nevojshme që ata të jenë anëtarë të Kuvendit të Komunës),
- të organizatave të shoqërisë civile apo të shoqatave,
- të institucioneve lokale, ndërmarrjeve publike në komunë, anëtarëve të bordeve drejtuese,
- të personave me aftësi të kufizuara, personave të zhvendosur, grave, të rinjve apo grupeve të tjera të cënueshme,
- të mediave (TV lokale, radiostacione, gazeta, etj.), dhe
- të akterëve tjerë të interesuar me integritet dhe përvojë të dëshmuar në luftën kundër korrupsionit.

ANALIZA E SITUATËS

04

Kjo është sigurisht pjesa më e rëndësishme e punës në procesin e hartimit të Planit komunal të veprimit në luftën kundër korrupsionit. Analiza e situatës na jep përgjigje në pyetjen ku jemi?, dhe kur kemi përgjigje në këtë pyetje, atëherë do ta kemi më të lehtë të dimë se ku duhet të shkojmë. Prandaj, nga një analizë adekuate, e paanshme dhe e mirë e gjendjes së korrupsionit në komunë, varet se çfarë dhe cilat masa kundër korrupsionit do të propozohen, nëse ato janë vetëm formale apo janë thelbësore dhe a e zgjidhin me sukses problemin e korrupsionit ekzistues. Formulimi i objektivave të Planit komunal të veprimit për luftën kundër korrupsionit në komunë, përcaktimi i treguesve të suksesit, ndarja e fondeve në buxhetin komunal për zbatimin e masave të propozuara kundër korrupsionit, monitorimi i suksesshëm i suksesit dhe zbatimi masave kundër korrupsionit dhe së fundi, ulja e korrupsionit ekzistues në komunë varet nga analiza e situatës.

SONDAZHI I OPINIONIT PUBLIK DHE ANGAZHIMI I QYTETARËVE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

05

Komuna mund të planifikojë një sondazh të opinionit publik përmes anketave anonime (online) lidhur me korrupsionin në një komunë të caktuar para dhe pas hartimit të Planit komunal të veprimit për luftën kundër korrupsionit. Pjesëmarrja e qytetarëve në monitorimin e zbatimit të masave të propozuara kundër korrupsionit dhe zbatimin e Planit komunal të veprimit për luftën kundër korrupsionit është me rëndësi të madhe.

PËRCAKTIMI I OBJEKTIVAVE

06

Qëllimi paraqet gjendjen e dëshirueshme dhe të pritshme që duhet të arrihet, gjegjësisht gjendjen që do të mundësojë luftimin e korrupsionit në fushë të caktuar pas zbatimit të Planit komunal të veprimit për luftën kundër korrupsionit. Një fushë mund të përbajë një ose më shumë objektiva, në varësi të karakterit dhe kompleksitetit të saj. Objektivat duhet të jenë të qarta, specifike, reale, të arritshme, të matshme dhe të jenë në gjendje të shprehen në mënyrë cilësore, sasiore dhe t'i referohen një periudhe të caktuar kohore.

PËRCAKTIMI I TREGUESVE

07

Kur përmes analizës së situatës kemi përcaktuar se ku jemi sa i përket korrupsionit, gjithashtu është e nevojshme të përcaktojmë se ku duam të jem në 3, 5 apo 10 vitet e ardhshme. Treguesit e caktuar duhet të përcaktohen rreth objektivave. Treguesit na tregojnë, vërtetojnë dhe matin nëse objektivat e caktuar janë arritur apo jo. Këta janë të ashtuquajturit treguesit e objektivave. Nëse qëllimi është të zvogëlohen ose eliminohen plotësisht parregullsitë e identifikuara në një zonë, treguesi do të ishte, për shembull, numri i kontrolleve të planifikuara dhe të parashikuara në atë zonë. Baza në këtë kuptim përfaqëson numrin e kontrolleve aktuale në atë fushë në një nivel të caktuar (për shembull "një kontroll në vit"), ndërsa vlera e synuar e treguesit do të ishte ajo e planifikuar në mënyrë që të mund të thuhet se një rritje në numrin e kontrolleve do të kontribuonte në synimin e reduktimit të parregullsive në atë fushë (për shembull "të paktën katër kontrolle në vit"). Treguesit mund të formulohen edhe në bazë të suksesit, dhe ata janë tregues të suksesit. Së fundi, komuna mund dhe duhet të propozojë tregues për çdo masë antikorrupsion që propozon. Të gjithë treguesit duhet të jenë të qartë, specifik dhe lehtësisht të matshëm.

Për shembull:

- numri i kontratave të nënshkruara të prokurimit në vitin 2022,
- numri i kontratave të publikuara të prokurimit në vitin 2022,
- Plani i miratuar i veprimit për luftën kundër korrupsionit,
- krijimi i një ekip për monitorimin dhe mbikëqyrjen e masave të propozuara nga Plani komunal i veprimit për luftën kundër korrupsionit,
- mbajtja e seminarit kundër korrupsionit për punëtorët e komunës,
- numri i punëtorëve të komunës në dijeni për Planin komunal të veprimit për luftën kundër korrupsionit,
- sondazhi i realizuar në komunën e _____ për korrupsionin,
- publikimi i Raportin për zhvillimin e Planit të veprimit për luftën kundër korrupsionit,
- publikimi i Raportit për zbatimin e Planit të veprimit për luftën kundër korrupsionit në vitin 2023,
- numri i raportimeve për korrupsion në komunë/numri i raportimeve të shqyrtuara të korrupsionit,
- numri i rekomandimeve të zbatuara nga Raporti i Auditorit
- lista e publikuar e dhuratave për kryetarin e komunës etj.

DËGJIM PUBLIK PËR DRAFT PLANIN KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR RRYTJEN E TRANSPARENCËS DHE LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

08

Legjislacioni i Kosovës përmban rregullore të mjaftueshme ligjore dhe nënligjore (rregullore dhe udhëzime administrative) për mbajtjen e dëgjimeve publike në komunë, me të cilat komunat tashmë janë njohur në detaje. Prandaj, këtu nuk do të ketë informacione dhe rekomandime shtesë.

THEMELIMI I NJË ORGANI PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË MASAVE NGA PLANI I VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

09

Para miratimit të Planit të veprimit për luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës, duhet të krijohet një organ që do të monitorojë zbatimin e të gjitha masave të propozuara për luftën kundër korrupsionit në komunën konkrete. Organi që do të mbikëqyrë zbatimin e masave kundër korrupsionit në një komunë të caktuar duhet të jetë i pavarur në punën e tij dhe asesi nuk duhet të jetë nën kontroll apo ndikim formal apo joformal të autoriteteve lokale. Anëtarët e organit nuk duhet domosdoshmërisht të jenë banorë të komunës. Organi duhet të ketë mandat që të kërkojë rregullisht informata dhe komente kthyes dhe prova për zbatimin e masave të propozuara kundër korrupsionit. Organi ose anëtarët e organit mund të kenë mandat të organizojnë mbledhjen e të dhënave për masat e miratuara kundër korrupsionit në një komunë të caktuar përmes intervistave, kërkesës për dokumente zyrtare me rëndësi publike në përputhje me ligjin, realizimit të pyetësorëve të veçantë etj.,

MIRATIMI I PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

10

Njoftimi zyrtar për miratimin e planit duhet të ndahet me mediat lokale dhe lajmi të publikohet në faqen zyrtare të komunës dhe rrjetet sociale. Komuna mund të organizojë një konferencë të veçantë ku Plani i veprimit për luftën kundër korrupsionit do të prezantohet para të gjithë qytetarëve të interesuar, përfaqësuesve të sektorit civil, institucioneve lokale, mediave etj.

RAPORTI PËR DRAFT PLANIN KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

11

Hartimi i një Plani komunal të veprimit për luftën kundër korrupsionit mund të jetë një proces afatgjatë që kërkon angazhimin e plotë të akterëve të ndryshëm dhe punën e koordinuar të disa ekipeve të ndryshme njerëzish.

Ata do të merren me analizën e situatës në terren, përcaktimin e treguesve të korrupsionit, formulimin e qëllimeve të planit për komunën e tyre, mënyrën e monitorimit të zbatimit të masave të propozuara kundër korrupsionit në komunë, etj. Prandaj do të ishte shumë e leverdishme dhe e dobishme për autoritetet komunale, por edhe për të gjithë të tjerët, nëse publikohet Raporti për përgatitjen e Planit të veprimit për luftën kundër korrupsionit. Raporti duhet të përmbajë informacion për të gjithë procesin e hartimit të planit, sfidat që kanë hasur anëtarët e grupit punës gjatë analizës së situatës dhe zhvillimit të planit, mësimet e nxjerra dhe rekomandimet për të tjerët, etj.

KRIJIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE TË PRONËS KOMUNALE

12

Administrata lokale shpeshherë nuk është e vetëdijshme për të gjitha mundësitë e zhvillimit ekonomik falë pronës komunale. Prandaj, duket se është e nevojshme të krijohet një bazë praktike e të dhënave që me një klikim do të mundësonte një pasqyrë të të gjitha parcelave që mund të përdorë komuna për qëllim të zhvillimit, ose një pasqyrë të parcelave që janë caktuar për përdorim nga subjektet private për të cilat ata paguajnë një të kompensim të caktuar, ose parcelat që nuk u janë lëshuar subjekteve private, por përdoren në mënyrë të paligjshme pa asnjë kompensim për pushtetin lokal (për shembull, një auto larje është e vendosur (pa leje) në një pllato të rregulluar në pronësi të komunës për të cilën nuk i paguhet kompensim komunës ose i paguhet zyrtarit komunal në kundërshtim me ligjin) ose kompensimi për shfrytëzimin e tokës komunale i paguhet zyrtarit komunal në kundërshtim me ligjin etj. Një bazë e tillë e të dhënave mbyll hapësirën për korrupsion. Në bazë të bisedave me zyrtarë të ndryshëm komunal, u krijua përshtypja se një bazë e tillë e të dhënave nuk ekziston, ose ekziston por nuk përdoret, etj.

KALIMI NË E-QEVERISJA

13

Konform ligjit në fuqi.

KALIMI NË E-PROKURIMI

14

Konform ligjit në fuqi.

PUBLIKIMI I PLANIT KOMUNAL TË MIRATUAR TË PROKURIMIT PËR VITIN AKTUAL NË FAQEN E KOMUNËS

15

Pas publikimit të Planit të Prokurimit, qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe të gjithë të interesuarit do të mund të marrin pjesë drejtpërdrejt në mbikëqyrjen e punës së administratës lokale dhe, nëse është e nevojshme, të kërkojnë llogaridhënie nga kryetari i komunës për menaxhim jo të mirë. Për shembull, plani i publikuar mund të tregojë nëse do të realizohet ndonjë projekt me prioritet gjatë vitit aktual, i cili është theksuar nga qytetarët gjatë dëgjimeve publike të mbajtura më parë për buxhetin kur pushteti lokal mori përsipër zbatimin urgjent të këtyre prioritetëve.

PUBLIKIMI I KONTRATAVE KOMUNALE TË NËNSHKRUARA ME OPERATORËT EKONOMIK

16

Kjo do të mundësonte një pasqyrë të plotë në mënyrën se si shpenzohen paratë publike nga administrata lokale. Nga diskutimet me përfaqësues të drejtorive të caktuara komunale, është vërejtur se ka një pakënaqësi të përgjithshme ndaj operatorëve të caktuar ekonomikë, por që pushteti lokal megjithatë vazhdimisht lidh kontrata me operatorë të tillë. Ky është treguesi i parë i korrupsionit. Publikimi i kontratave të prokurimit do t'u mundësonte qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile, mediave dhe të gjitha palëve të interesuara mundësinë e një kontrolli më të madh.

THEMELIMI OSE FUNKSIONALIZIMI I QENDRËS SË SHËRBIMEVE PËR QYTETARË

17

Legjislacioni kosovar e parasheh këtë obligim për qeveritë lokale. Vendosja e të gjitha ose shumicës së shërbimeve komunale në një vend është hapi i parë drejt rritjes së transparencës dhe zvogëlimit të mundësisë së korrupsionit, sepse përmes Qendrës së Shërbimit për Qytetarë pranohen të gjitha kërkesat, shqyrtohen në mënyrë elektronike (nëpërmjet intranetit ose një programi tjetër që është në përdorim në komunitet e Kosovës) dhe miratohen, prandaj edhe mundësia për korrupsion është shumë më e vogël. Kjo është një nga mënyrat që administrata lokale të zvogëlojë mundësinë e kontaktit të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara dhe zyrtarëve komunalë dhe të bëjë ndarjen e detyrave gjë që parandalon shpërdorimin e detyrës dhe korrupsionin. Bisedat me zyrtarët komunalë konfirmuan se në disa komuna partnere pranimi, shqyrtimi, vendimmarrja, realizimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të vendimit bëhet nga 3 në vend të 4 apo 5 punonjësve të ndryshëm të komunës, ose se teknologjia informative dhe programet softuerike për këtë qëllim nuk përdoren fare, etj.

RAPORTI MBI REKOMANDIMET E ZBATUARA NGA RAPORTI I ZYRËS SË KOMBËTARE TË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM TË KOSOVËS PËR KOMUNË

18

Çdo vit, Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës përgatit Raportin për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të komunës për vitin konkret. Ky raport është përgatitur në bazë të një analize të detajuar të shpenzimit të parashë publike nga organet e qeverisë lokale dhe përmban informacione dhe rekomandime për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit komunal, progresin në zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. Është shumë e rëndësishme që në nivel komunal të parashihet përgjegjësi e veçantë e punëtorëve të caktuar apo autoriteteve komunale në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm dhe raportimit transparent në këtë drejtim.

PUBLIKIMI I LISTËS SË DHURATAVE TË ZYRTARËVE TË LARTË NË FAQEN E KOMUNËS

19

Kryetari i komunës duhet të tregojë se i zbaton mjetet e qeverisjes së mirë, e një ndër to mund të jetë edhe kjo. Përkatësisht, Komuna duhet të përdorë praktikën e publikimit në faqen e saj të listës së dhuratave që kryetari i komunës dhe zyrtarët e tjerë pranojnë gjatë vitit. Dy herë në vit, një zyrtar i caktuar komunal duhet të përditësojë listën e dhuratave dhe vlerat e tyre dhe listën ta publikoj në faqen e komunës. Qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe të gjithë të interesuarit duhet që rreth kësaj të informohen nga pushteti lokal.

ALOKIMI I BUXHETIT KOMUNAL PËR ZBATIMIN E PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

20

Në përputhje me planin e veprimit për luftën kundër korrupsionit, komuna do të duhej të alokonte në buxhetin e saj fonde në baza vjetore, të cilat do të përdoreshin drejtpërdrejt për aktivitetet e parashikuara në plan dhe që synojnë promovimin e transparencës, uljen e korrupsionit dhe të ngjashme.

LISTA E ZEZË TË FURNITORËVE OSE NËNKONTRAKTORËVE OSE KONTRAKTORËVE TË KONTRATAVE KOMUNALE TË DHËNA

21

Është e nevojshme që çdo komunë të aprovojë dhe të mbajë një listë të zezë të furnitorëve/nënkontraktorëve që nuk kanë respektuar detyrimet e marra nga kontratat e nënshkruara me komunën. Është gjithashtu e nevojshme të formulohen treguesit e performancës së prokurimit për të monitoruar dhe përmirësuar punën e prokurimit me kalimin e kohës: pra numrin e ankesave, kohë nga hapja e ofertës deri në dhënien e kontratës, numrin e ndryshimeve të kontratës, rritjen e çmimeve etj.

INFORMIMI I PUNËTORËVE TË KOMUNËS RRETH PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

22

Informimi i punëtorëve të komunës rreth Planit ekzistues komunal të veprimit për luftën kundër korrupsionit dhe të gjitha masat e propozuara, përfshirë përgjegjësitë reciproke, kompetencat dhe afatet për realizimin e masave të zbatuara.

SEMINAR PËR MASAT ANTIKORRUPSION TË KOMUNËS

23

Përveç informimit, është e nevojshme që zyrtarët përkatës komunal të trajnohen për zbatimin e planit të miratuar. Prandaj ky seminar duhet të forcojë më tej kapacitetin e punëtorëve për të kuptuar se çfarë është korrupsioni dhe si të trajtohet në rrethanat më të vështira. Trajnimi duhet veçanërisht të rrisë vetëdijen e punëtorëve për të drejtën e tyre për të ditur gjithçka që bëhet apo nuk bëhet në komunë, si dhe për të raportuar çdo parregullsi. Gjithashtu, trajnimi duhet të fokusohet në sistemin e vendosur të kontrollit dhe raportimit të korrupsionit në komunë, si dhe rreth kompetencave të reja që organet e caktuara komunale kanë marrë me qëllim të zbatimit të Planit të miratuar të veprimit për luftën kundër korrupsionit.

VLERËSIMI I RREZIKUT TË KORRUPSIONIT NË KOMUNË

24

Komuna duhet të krijojë një praktikë dhe një mënyrë që (të paktën) një herë në vit në mënyrë sistematike, të organizuar dhe institucionale, me pjesëmarrjen e plotë të publikut, të vlerësojë suksesin e zbatimit të Planit të veprimit për luftën kundër korrupsionit përmes vlerësimit e rrezikut të korrupsionit. Prandaj, plani i veprimit duhet të plotësohet dhe masat të përshtaten, si dhe përgjegjësitë e drejtorive dhe sektorëve komunal që kontrollojnë dhe zbatojnë masat e miratuara kundër korrupsionit duhet sistematikisht të vlerësohen.

NUMRI PËR RAPORTIMIN E KORRUPSIONIT NË FAQEN E KOMUNËS

25

Komuna duhet të publikojë një numër telefoni ku qytetarët në mënyrë të sigurt të mund të raportojnë korrupsionin tek shërbimet kompetente. Përveç numrit të raportimit të korrupsionit kudo në Kosovë, komuna mund të krijojë sistemin e vet që mundëson raportimin anonim të korrupsionit, shkeljes së ligjeve, standardeve profesionale apo etikës. Për këtë qëllim, është e nevojshme të miratohet një procedurë e veçantë me të cilën qytetarët do të njihen dhe e cila duhet të ndiqet me rastin e raportimit të rasteve të korrupsionit, mashtrimit apo parregullsive të tjera. Procedura për denoncimin e korrupsionit sigurisht që duhet të jetë në përputhje me Ligjin nr. 04/L-043 për mbrojtjen e informatorëve, i cili rregullon mbrojtjen e sinjalizuesve për sinjalizimin e shkeljeve në Kosovë.

KONTROLLI DHE MONITORIMI I SHËRBIMEVE KADASTRALE TË KOMUNËS

26

Të ndërmerren masa për mbështetjen e funksionit të kadastrit me staf profesional dhe trajnime të duhura profesionale, të cilat janë të nevojshme për kryerjen e detyrave dhe obligimeve në përputhje me ligjin. Si rregull, shërbimet kadastrale duhet të jenë në dispozicion të qytetarëve përmes Qendrës së Shërbimit për Qytetarë dhe programeve të veçanta (intranet apo programe softuerike të tjera të specializuara kadastrale dhe programe që përdoren nga të gjitha komunat në Kosovë). Në këtë mënyrë parandalohet kontakti i drejtpërdrejtë mes qytetarëve dhe stafit të Drejtorisë së Kadastrit në komunë, shqyrtimi i kërkesave bëhet sipas

radhës, dhe për këtë arsye korrupsioni i mundshëm reduktohet në minimum. Bisedat me zyrtarë të komunave të caktuara konfirmuan se në komunat e tyre Drejtoria e Kadastrit është më e ndjeshme kur bëhet fjalë për korrupsionin e autoriteteve të qeverisë lokale. Prandaj një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet integritetit të punëtorëve të Drejtorisë së Kadastrit, punëtorëve të Qendrës së Shërbimit të Qytetarëve, atyre punëtorëve që kryejnë regjistrimin ose bashkimin e parcelave, shpërndarjen e subvencioneve, dhënien e lejeve për shfrytëzim dhe rregullim të tokës komunale etj. Prandaj, qytetarëve duhet t'u mundësohet që lehtësisht dhe në mënyrë anonime të vënë në dukje parregullsitë e mundshme në punën e Drejtorisë së Kadastrit në secilën komunë partnere.

I VLERËSIMI I INTEGRITETIT TË PUNËTORËVE TË KOMUNËS

27

Komuna duhet të krijojë një praktikë të vlerësimit të integritetit të punëtorëve të saj. Bisedat me zyrtarët komunalë konfirmuan se në komunat partnere në një periudhë kohore të caktuar ka pasur hetime, arrestime dhe aktgjykime gjyqësore për korrupsion. Prandaj, do të ishte e dobishme që të krijohet praktika e vlerësimit të integritetit të punëtorëve, dhe në përputhje me rezultatet e vlerësimit dhe nevojat të bëhet riorganizimi dhe sistematizimi i nevojshëm i vendeve të punës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për punëtorët e zyrave të pritjes, qendrave të shërbimit për qytetarë, zyrtarëve kadastralë të cilët lëshojnë leje të ndryshme (p.sh. lejet për ndërtimin e vilave në Ski qendrën e Brezovicës në Malet e Sharrit, apo leje për kryerjen e punimeve në Parkun Kombëtar Malet e Sharrit etj.). Prandaj, për të gjithë, e veçanërisht për punëtorët e shërbimeve dhe drejtorive të përmendura komunale, është e nevojshme të bëhen vlerësime periodike të punës dhe vlerësime të integritetit të punëtorëve, gjë që do të mundësonte zbulimin e korrupsionit dhe eliminimin e shkaqeve të shfaqjes së tij. Vlerësimi i integritetit të punëtorëve do të jepte informacion jo vetëm nëse punëtorët e caktuar në pozicione "të ndjeshme" marrin ose japin ryshfet, por nëse edhe përmbushin të gjitha kërkesat etike dhe profesionale për kryerjen e detyrave dhe obligimeve të tyre. Vlerësimi i integritetit të punëtorëve, së bashku me masat e vazhdueshme, është në mjet shumë i rëndësishëm parandalues në zbulimin dhe eliminimin e shkaqeve, pra rreziqeve për shfaqjen dhe zhvillimin e korrupsionit.

RAPORTI VJETOR I KOMUNËS PËR ZBATIMIN E MASAVE ANTIKORRUPSION NGA PLANI I VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

28

RIORGANIZIMI RADIKAL I SISTEMIT EKZISTUES TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM DHE TË INSPEKTIMIT

29

LISTA E REKOMANDIMEVE ME NJË SHPJEGIM TË SHKURTËR

HARTIMI DHE MIRATIMI I RREGULLOREVE
DHE AKTEVE QË DO TË MUNDËSOJNË
LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT NË
NIVEL TË QEVERISË LOKALE

30

HARTIMI DHE MIRATIMI I PLANIT
VJETOR PËR PJESËMARRJE TË
SUKSESSHME TË QYTETARËVE NË
DEBATET PUBLIKE GJATË PËRPILIMIT
TË BUXHETIT KOMUNAL

31

HARTIMI DHE MIRATIMI I KODIT TË
INTEGRITETIT DHE ANTIKORRUPSIONIT TË
ZYRTARËVE KOMUNALË DHE ZYRTARËVE
TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE

32

PËRDITËSIMI I FAQES ZYRTARE TË
KOMUNËS ME INFORMACIONE DHE
DOKUMENTE TË NEVOJSHME

33

PËRPILIMI I LISTËS SË REKOMANDIMEVE
DHE KRIJIMI I MEKANIZMAVE KOMUNAL
PËR ZBATIMIN E KORNIZËS LIGJORE PËR
LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT NË
KOSOVË

34

(SHIH KAPITULLIN “KORNIZA LIGJORE” MË LART)

VENDOSJA E BASHKËPUNIMIT
INSTITUCIONAL NDËRMJET AGJENCISË
KUNDËR KORRUPSIONIT NË KOSOVË
DHE TË NJËJTËS AGJENCI NË SERBI ME
QËLLIM TË SHQYRTIMIT TË PASURISË
SË ZYRTARËVE TË LARTË

35

PUBLIKIMI I LISTËS SË SUBVENCIONEVE
TË DHËNA PËR QYTETARËT E KOMUNËS
PËR VITIN AKTUAL

36

LISTA E
REKOMANDIMEVE
ME NJË SHPJEGIM TË
SHKURTËR

HARTËZIMI I RREZIQEVE TË
KORRUPSIONIT DHE KRIJIMI I REGJISTRIT
TË RREZIQEVE NGA KORRUPSIONI

37

VENDOSJA E MEKANIZMAVE DHE
FORMËS SË NJOFTIMIT TË PUBLIKUT
PËR BUXHETIN E REALIZUAR KUNDREJT
BUXHETIT TË PLANIFIKUAR TË KOMUNËS

38

VENDOSJA E MEKANIZMAVE DHE
FORMËS SË NJOFTIMIT TË PUBLIKUT
PËR BUXHETIN E REALIZUAR KUNDREJT
BUXHETIT TË PLANIFIKUAR TË KOMUNËS

39

VENDOSJA E NJË PRAKTIKE PËR
DHËNIEN E SHPËRBLIMIT KOMUNAL
PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

40

FORMIMI I NJË KOMISION KOMUNAL
PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

41

PËRGATITJA DHE SHPËRNDARJA E
PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR
LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT NË
FORMËN E NJË BROSHURE/MANUALI

42

PUBLIKIMI I PROCESVERBALEVE TË
SEANCave TË KUVENDIT KOMUNAL
DHE REZULTATEVE TË VOTIMIT PËR
PIKAT E RENDIT TË DITËS

43

HARTIMI I NJË PLANI TË VEPRIMI
TË KUVENDIT KOMUNAL PËR
TRANSPARENCËN DHE PJESËMARRJEN
E QYTETARËVE (NËSE NUK EKZISTON)

44

